

**U D H Ë Z I M**  
**Nr. 14 datë 18.10.1993**

**PËR PROCEDURËN E ANKANDIT TË SHITJES SË MALLRAVE ME SHUMICË**

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

**U D H Ë Z O N:**

**I. PËRKUFIZIME DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Me "Mallra me shumicë" kuptohen mallrat ushqimorë të blera me fonde të buxhetit të shtetit, ose të siguruara nëpërmjet ndihmave e kredive shtetërore.
2. Me "Ent shitës" kuptohet subjekti publik që bën shitjen.
3. Me "Komision" kuptohet grupi i specialistëve të entit shitës që realizon procedurën e shitjes.
4. Me "Fitime ose konkurrues" kuptohet personi fizik dhe juridik shqiptar.
5. Shitja e mallrave me shumicë duhet të garantojë të drejtën e barabartë të konkurruesve për të konkurruar dhe administrimin e mirë e rigoroz të mallit të dhënë në dispozicion nga organi qëndror shtetëror.
6. Procedura e shitjes synon të mos lejojë diskriminimin e konkurruesve.
7. Kjo procedurë fillon nga enti shitës pas lëshimit të urdhërshitjes nga titullari i organit qëndror që disponon mallin me shumicë, ku shënohen enti shitës, objekti shitës, sasia dhe vlefëta.
8. Procedura e shitjes së mallrave me shumicë nuk zbatohet në rastet e ndihmave e të kredive për aq sa ato bien në kundërshtim me kushtet dhe marrëveshjet e mitatuara me donatorët.
9. Enti shitës e realizon shitjen nëpërmjet komisionit, i cili përgjigjet për veprimtarinë e tij.
10. Komisioni caktohet me urdhër me shkrim të titullarit të entit shitës dhe përbëhet nga jo më pak se 4 veta, ndër të cilët rekomandohet zëvendëstitullari, drejtuesi i sektorit financiar, juristi dhe një specialist i kualifikuar sipas objektit të shitjes.
11. Drejtuesi i komisionit zëvendësohet vetëm në raste të veçanta dhe për arsye objektive, kurdoherë me urdhër me shkrim të titullarit të entit shitës ku shënohet arsyeja e zëvendësimit.
12. Komisioni zbaton për çdo rast formën e shitjes me shumicë sipas këtij udhëzimi.

**II. FORMAT E KOMUNIKIMIT**

1. Njoftimet e entit shitës për organizimin e ankandit të hapur bëhen:
  - a) Në një buletin ose, në mungesë të tij, të paktën në dy gazeta të mëdha kombëtare.
  - b) Kur komisioni e gjykon të nevojshme, rekomandohen si plotësuese edhe forma të tjera komunikimi, si afishimi e radio e televizioni.
2. Të gjitha komunikimet ndërmjet entit shitës dhe konkurruesve dokumentohen e ruhen.
3. Njoftimi dhe komunikimi bëhen sipas rregullave që përcaktohen në këtë udhëzim.

**III. SHITJA E MALLRAVE ME SHUMICË NË ANKAND TË HAPUR**

Shitja e mallrave me shumicë në ankand të hapur është forma më e përgjithshme, me të cilën garantohet konkurrenca e lirë e konkurruesve dhe respektohet barazia ndërmjet tyre. Ankandi quhet i hapur, kur në të kanë të drejtë të konkurrojnë të gjitha firmat që i përgjigjen njoftimit përkatës të bërë nga enti shitës, dhe përdoret për të siguruar ofertën që ofron objektin e shitjes me çmimin më të leverdisshëm që mund të arrihet nga konkurrenca dhe pjesëmarrja e sa

më shumë firmave të ndryshme brenda vendit.

#### IV. PROCEDURA E SHITJES SË MALLRAVE ME SHUMICË

1. Procedura fillon me lëshimin e urdhërit të shitjes (1-7)

2. Komisioni për vlerësimin e ofertave përcakton kriteret e vlerësimit paraprak që lidhen me plotësimin e dokumentacionit dhe respektimin e kushteve të parashikuara në ftesën e ankandit, si dhe kriterin e vlerësimit ekonomik, që, pavarësisht nga sasia, përparësi në vlerësim do të kenë ofertat, duke filluar me çmime më të larta dhe deri në ato me çmime të barabarta me çmimin minimal të shitjes. Kriteret e vendosura shpallen nga komisioni qysh në fillim të procedurës së ankandit.

3. Komisioni përgatit njoftimin dhe e shpall atë sipas pikës (II-a), të cilit i vihet një numër referimi. Njoftimi përmban adresën e entit shitës, objektin e shitjes, të dhëna teknike e specifikime, çmimin maksimal të shitjes për sasinë totale ose të loteve, sasinë totale ose ndarjen e saj në lote, ku dhe si do të sigurohen dokumentet e ofertës së ankandit, afatin e fundit të paraqitjes së ofertës, vendin, datën dhe orën e hapjes së zarfëve të ofertave, si dhe pjesëmarrjen në hapjen e tyre.

4. Komisioni përgatit dokumentacionin e ftesë së ankandit sipas aneksit nr.1 dhe formularin e ofertës së ankandit sipas aneksit nr.2 që i bashkëngjiten këtij udhëzimi.

5. Dokumentacioni i ankandit i përgatitur nga komisioni u dorëzohet konkurruesve që paraqiten në bazë të njoftimit të bërë nga enti shitës.

6. Afati i fundit i pranimit të ofertave nuk duhet të jetë më pak se 15 ditë nga data e fundit e publikimit të njoftimit. Afati vendoset nga komisioni për çdo rast konkret. Të gjitha ofertat e paraqitura regjistrohen nga enti shitës.

7. Oferta duhet të paraqitet me një zarf, i cili duhet të jetë i mbyllur dhe i vulosur. Në anën e përparme të tij duhet të shkruhet adresa e entit shitës, numri i referencës së njoftimit dhe brenda të ketë dokumentin e ftesës së ankandit (aneksi nr.1), formularin e ofertës së ankandit (aneksi nr.2) dhe dokumentin bankar të lëshuar nga dega e bankës së konkurruesit. Të gjitha dokumentet duhen të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga titullari i firmave konkurruese. Nëse zarfi nuk është i vulosur ose nuk ka të shënuara kërkesat e përmendura më sipër, enti shitës nuk mban përgjegjësi për eliminimin e ofertës.

8. Konkurruesi ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 5 ditë para afatit të fundit të pranimit të ofertave.

9. Zarfët që mbërrijnë më vonë se data e caktuar, regjistrohen dhe i kthehen menjëherë e të pahapura konkurruesve.

10. Për raste të veçanta, kur në datën e caktuar nuk paraqitet asnjë ofertë, komisioni mund të vendosë e shpallë në të njëjtin organ ku ka bërë njoftimin shtyrjen e afatit të fundit të pranimit të ofertave deri në 5 ditë. Nëse edhe në afatin e ri nuk paraqitet ndonjë ofertë, komisioni duhet të përmirësojë dosjen e ankandit dhe të rifillojë procedurën nga e para.

11. Zarfët hapen nga komisioni në ditën, orën dhe vënin e caktuar, të njoftuar që në fillim të procedurës së ankandit.

12. Në seancën e hapjes së zarfëve, përveç komisionit, marrin pjesë dhe përfaqësues të konkurruesve, duke paraqitur autorizimin përkatës.

13. Shqyrtimi i ofertave të regjistruara bëhet menjëherë, siç është vendosur dhe shpallur më parë në njoftim. Shqyrtimi bëhet në dy faza:

a) Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin e dokumenteve, formën e paraqitjes së tyre etj. Këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe kriteret e shpallura, oferta përjashtohet nga konkurrimi i mëtejshëm. Për këtë fazë përgatet me shkrim raporti i hapjes së ofertave për gjithë konkurruesit.

b) Faza e dytë është shqyrtimi ekonomik, ku analizohen sasinë, çmimet, verifikohen

vleftat etj.

14. Ofertat e vlerësuara si të rregullta pas shqyrtimit paraprak krahasohen ndërmjet tyre sipas vlerësimeve të fazës së dytë dhe klasifikohen. Për këtë fazë (b) përgatitet me shkrim raporti i vlerësimit të ofertave për çdo konkurrues. Oferta që konsiderohet më e mirë, shpallet fituese dhe afishohet në entin shitës.

15. Në rast se konkurrusi që ka fituar nuk pranon dhe tërhiqet nga ankandi, kjo dokumentohet dhe fituese shpallet oferta e çmuar si e dyta më e mirë.

16. Pas shpalljes së konkurruesit fitues enti shitës lidh me të kontratën, përgatit autorizimin (duke pasur bashkëlidhur emrin e konkurruesit fitues të ankandit) dhe e dërgon menjëherë në degën e bankës së blerësit, duke kërkuar që blerësi të bëjë pagesën, sipas dokumentit bankar të lëshuar nga dega e bankës (IV-8) për ata konkurrues, në llogarinë bankare të entit shitës.

17. Pas paraqitjes së dokumentit nga dega e bankës së blerësit për pagesën e bërë prej tij, enti shitës autorizon për fillimin e shpërndarjes së mallit.

18. Dosja e plotë e dokumenteve të ankandit ruhet nga enti shitës. Në të nuk lejohen korrigjime dhe mund t'i jepet për shqyrtim vetëm personave që autorizohen nga titullari i entit shitës.

19. Komisioni mund ta anulojë ankandin, kur:

- a) Asnjë ofertë nuk kënaq kushtet ekonomike të kërkuara.
- b) Të gjitha ofertat përmbajnë parregullsi thelbësore që e pengojnë shqyrtimin normal të tyre.

## VI. ANKIMI

1, Çdo konkurrues, kur vëren shkelje të procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, ka të drejtën e ankimit.

2. Për procedurën e ankimit zbatohet vendimi i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**ALEKSANDËR MEKSI**

## ANEKSI 1

### FTESË PËR ANKANDIN E SHITJES SË MALLRAVE ME SHUMICË

Ftesa për ankand përmban :

- 1) Adresën e plotë të entit shitës,
- 2) Numrin e referimit të ankandit,
- 3) Objektin e shitjes,
- 4) Sasinë totale dhe ndarjen në lote minimale të sasisë që do të shitet.
- 5) Çmimin minimal për të gjithë sasinë dhe për çdo lot.
- 6) Kriteret dhe kushtet e përgjithshme përmbajnë :
  - a) Ofertat që paraqiten më vonë se afatet e përcaktuara në njoftim, nuk pranohen.
  - b) Mënyrën dhe afatet e paraqitjes së ofertës. Oferta duhet të përmbajë :
    - Dokumentin e ftesës së ankandit (aneksin nr.1)
    - Formularin e ofertës së ankandit (aneksin nr.2)
    - Dokumentin bankar të marrë nga degët e bankës në rrethe (garancia bankare), ku të shënohet garancia e pagesës prej saj për vleftën e ofruar nga konkurruesi.

c) Pjesëmarrjen e konkurruesve.

7. Ofertat me çmime më të larta do të pranohen derisa të mbarojë numri i loteve të caktuara, gjithmonë për ato oferta që janë më të larta ose të barabarta me çmimin minimal të shitjes.

8. Shpenzimet e transportit do të përballohen nga blerësi ose enti shitës, sipas gjykimit të komisionit. Rekomandohet që me konkurruesit privatë shpenzimet e transportit të bëhen nga vetë ata.

9. Afati i fundit i tërheqjes së mallit sipas gjykimit të komisionit.

10. Tarifa e caktuar për çdo ditë vonesë për mall në ruajtje, si dhe të gjitha zhdëmtimet e tjera që lidhen me të.

11. Për konkurrues me kushte të barabarta do të bëhet votim nga komisioni.

12. Asnjë shpërndarje malli nuk do të bëhet deri sa të mos jetë marrë dokumenti bankar i pagesës së blerësit për mallin, nga një degë e bankës në llogarinë bankare të entit shitës.

13. E drejta e entit shitës për të anuluar çdo ofertë.

14. Rezultati i vetëm i vlerësimit të ofertave fituese do të shpallet dhe afishohet në entin shitës.

Firma (emri i firmës) fituese e ofertës së ankandit të zhvilluar në datën... për objektin e mallit (emërtimi i mallit\_është dakord që të :

a) Pranojë të blejë sipas ofertës së paraqitur.

b) Tërheqë mallin sipas afatit të përcaktuar nga komisioni i entit shitës që fillon nga data e lidhjes së kontratës (kur sipas marrëveshjes ndërmjet dy palëve transoporti kryhet nga blerësi).

c) Nëse blerësi (kur transoporti kryhet nga blerësi sipas marrëveshjes) nuk e tërheq mallin brenda afatit të caktuar, enti shitës shkarkohet nga të gjitha përgjegjësitë dhe asnjë ankesë nuk mund të bëhet ndaj tij. Në këtë rast blerësi penalizohet për dëmin e shkaktuar, sipas kuishteve të përcaktuara në kontratë,

ç) Pas tërheqjes të gjithë sasisë së mallit nga magazinat e entit shitës, blerësi bën delaratën e marrjes në dorëzim të mallit, duke bërë nënshkrimin dhe vulosjen e këtij dokumenti.

Firma

Emri

Adresa

Vula

## ANEKSI 2

### FORMULARI I OFERTËS SË ANKANDIT

#### RREGULLA E SQARIME

Secili lot i mallit (emërtimi i mallit) përmban sasinë në ton. Vendosni çmimin në lekë për lot dhe numrin total të lotëve, si dhe vlef tën totale që ju votoni për të blerë.

Asnjë konkurrues nuk mund të votojë për më shumë se numri i loteve, të caktuar qysh në fillim nga enti shitës.

Ofertave më të mira sipas klasifikimit do t'i jepet përparësi në pranim.

Nëse gjatë vlerësimit në ankand ka disa konkurrues që kanë ofruar çmim ofertës më të mirë. Votimi do të organizohet duke vendosur emrat e konkurruesve në një kuti dhe komisioni,

sipas tërheqjes së emrave, bën klasifikimin e konkurruesve.

Deklaratë:

Firma (emri i firmës) ofron çmimin (në numër dhe fjalë) për secilin lot dhe për totalin e loteve ( numër dhe fjalë), vleftën totale (në numër e fjalë).

Bashkëlidhur paraqesin garancinë bankare nr....., datë....., të lëshuar nga dega e bankës (emri i degës së bankës), që garanton pagesën nga ana jonë të vleftës totale (në numër e fjalë).

Firma

Emri

Adresa

Vula